



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

PLANI I VEPRIMIT PËR FAKULTETIN E EDUKIMIT
(2024-2025)

Gjilan, 2024

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|---|----------|
| PLANI I VEPRIMIT PËR FAKULTETIN E EDUKIMIT | 1 |
| 1. Qëllimi i Planit të Veprimit | 3 |
| 1.1. Objektivat kryesore | 3 |
| 2. Analiza e gjendjes aktuale | 5 |
| 3. Përshkrimi i Programeve | 6 |
| 4. Tabela e Planit të Veprimit..... | 8 |

PLANI I VEPRIMIT PËR FAKULTETIN E EDUKIMIT

1. Qëllimi i Planit të Veprimit

Plani i Veprimit për Fakultetin e Edukimit ka për qëllim të ofrojë një kornizë të qartë dhe të strukturuar për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e mësimdhënies, kurrikulës, mbështetjes ndaj studentëve dhe proceseve administrative. Ky plan synon të adresojë nevojat e programeve bacheloret dhe master përmes objektivave strategjike dhe veprimeve të konkretizuara. Qëllimet kryesore janë:

- **Përmirësimi i cilësisë së arsimit**
- **Zhvillimi Profesional i stafit**
- **Zhvillimi i infrastrukturës**
- **Mbështetja e studentëve**
- **Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi**

1.1. Objektivat kryesore

Objektivat kryesore janë të ndara në disa objektiva specifike për të siguruar zhvillimin e programeve akademike dhe përmirësimin e kapaciteteve të stafit dhe studentëve.

1. Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve studimore

- **Rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave:**
Përditësimi i kurrikulave të programeve bacheloret dhe master për të reflektuar zhvillimet bashkëkohore në fushën e arsimit dhe kërkesat e tregut të punës.
- **Rishikimi i Syllabuseve :**
Përpunimi i rezultateve të nxënësve të syllabusit me rezultatet e nxënësve të programit
- **Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor:**
Përdorimi i mjeteve digjitale dhe teknologjike për të pasuruar metodat e mësimdhënies dhe për të përgatitur studentët për sfidat bashkëkohore.

2. Rritja e cilësisë së mësimdhënies

- **Trajnime për metodat bashkëkohore të mësimdhënies:**
Organizimi i trajnimeve të rregullta për stafin akademik për të përvetësuar metoda kreative dhe inovative të mësimdhënies.
- **Zhvillimi i praktikave pedagogjike:**
Mbikëqyrje sistematike e praktikave pedagogjike dhe rishikim i doracakut të praktikave për të përputhur përvojën praktike me kërkesat bashkëkohore të arsimit.
- **Zhvillimi i materialeve didaktike:**
Hartimi i materialeve të reja didaktike dhe burimeve mësimore për të mbështetur procesin e mësimdhënies.

3. Zhvillimi profesional i stafit akademik

- **Trajnime dhe kualifikime të avancuara:**
Inkurajimi i stafit për të ndjekur kualifikime të mëtejshme dhe për të marrë pjesë në programe të zhvillimit profesional.
- **Mbështetja për publikime shkencore:**
Promovimi i kërkimit shkencor dhe publikimeve në revistat Scopus dhe Web of Science për të rritur cilësinë dhe reputacionin akademik të fakultetit.
- **Mbështetje për zhvillim të projekteve dhe bashkëpunime ndërkombëtare:**
Nxitja e stafit akademik për zhvillim të projekteve si dhe bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare për të pasuruar përvojën dhe njohuritë e stafit.

4. Përmirësimi i mbështetjes për studentët

- **Mentorim dhe Këshillim:**
Ofrimi i programeve të mentorimit për studentët për të ndihmuar në suksesin akademik dhe profesional.
- **Mbështetje psikologjike dhe akademike:**
Krijimi i shërbimeve për mbështetje psikologjike dhe akademike për të gjithë studentët.

5. Përmirësimi i infrastrukturës dhe administrimit

- **Modernizimi i infrastrukturës:**
Pajisja e sallave dhe laboratorëve me teknologji të reja për të mbështetur mësimdhënien efektive.

- **Monitorimi dhe vlerësimi i performancës:**
Avansim i mekanizmave për monitorimin e cilësisë së arsimit dhe administrimit për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm.

2. Analiza e gjendjes aktuale

Programet e Studimit në Fakultetin e Edukimit

| Programe Bachelor | Programe Master |
|---------------------|--|
| Arsimi Parashkollor | Mësimdhënie e Kurrikula për Programin Fillor |
| Arsimi Fillor | Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe |

Numri i stafit akademik/Administrativ

| | |
|------------------------|----|
| Profesorë të rregullt | 19 |
| Asistentë të angazhuar | 10 |
| Administratë | 3 |

Numri i studentëve

| | |
|--------------------|-----|
| Programet bachelor | 238 |
| Programet master | 95 |
| Gjithsej | 333 |

Infrastruktura

| | |
|----------------------------------|---|
| Salla të ligjëratave | 10 salla për ligjëratë, të pajisura, disa me teknologji bazike si projektorë dhe tabela interaktive |
| Laboratorë dhe hapësira praktike | 1 Kabinet i Artit Muzikor 1 laborator për Shkencat e Natyrës 1 laborator i IT -sw 1 klasë për simulime të mësimdhënies për praktikën pedagogjike |

| | |
|-----------------------------|---|
| Biblioteka | Rreth 3,000 tituj të literaturës shkencore dhe profesionale Akses i kufizuar në burime digjitale ndërkombëtare. |
| Infrastrukturë teknologjike | Wi-Fi i disponueshëm në të gjithë objektin e fakultetit. Nevojë për përmirësim të teknologjisë në disa salla të mësimi dhe laboratorë. |
| Hapësira për studentët | Mungesë e hapësirave të dedikuara për punë në grup dhe aktivitete jashtëkurrikulare. |

Sfidat kryesore

1. **Infrastruktura e vjetëruar:** Nevojë për modernizim të pajisjeve teknologjike dhe hapësirave të mësimi.
2. **Burime të kufizuara didaktike:** Nevojë për përditësim të literaturës dhe shtim të resurseve digjitale.
3. **Kapacitetet e stafit:** Nevojë për trajnime të vazhdueshme për stafin në përdorimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies.
4. **Mbështetja për studentët:** Nevojë për zhvillimin e programeve mbështetëse dhe mentorim për studentët.

3. Përshkrimi i Programeve

Bachelor në Arsimin Parashkollor

Përshkrimi i Programit: Programi bachelor në Arsimin Parashkollor synon të përgatisë edukatorë të aftë për të punuar me fëmijët e moshës 0-6 vjeç. Kurrikula përfshin lëndë teorike dhe praktike që mbulojnë zhvillimin e fëmijëve, metodologjitë e mësimdhënies, psikologjinë e fëmijërisë së hershme dhe menaxhimin e klasës. Studentët angazhohen në praktika profesionale në institucione parashkollore për të fituar përvojë reale në terren.

Sfidat Aktuale:

- **Përditësimi i Kurrikulës:** Nevoja për të integruar qasjet më të fundit pedagogjike dhe teknologjike në program.
- **Praktikat Profesionale:** Sigurimi i bashkëpunimeve të qëndrueshme me institucionet tjera parashkollore për praktika cilësore.
- **Burimet Didaktike:** Përmirësimi i materialeve mësimore dhe burimeve të tjera për të mbështetur mësimdhënien efektive.

Bachelor në Arsimin Fillor

Përshkrimi i Programit: Ky program synon të përgatisë mësues për arsimin fillor (klasat 1-5), duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive pedagogjike dhe njohurive të nevojshme për mësimdhënie efektive. Kurrikula përfshin lëndë nga shkencat shoqërore, natyrore, gjuhës shqipe dhe matematikës, si dhe metodologjitë e mësimdhënies për secilën fushë. Studentët kryejnë praktika mësimore në shkolla fillore për të aplikuar njohuritë e fituara.

Sfidat Aktualet:

- **Integrimi i Teknologjisë:** Përfshirja e mjeteve digjitale në procesin mësimor për të përgatitur studentët për mësimdhënie bashkëkohore.
- **Zhvillimi Profesional i Stafit:** Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin akademik në metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies.
- **Mbështetja për Studentët:** Ofrimi i programeve mbështetëse dhe mentorimit për të ndihmuar studentët në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Master në Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor

Përshkrimi i Programit: Programi master në Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor është dizajnuar për të avancuar njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve në planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e kurrikulave në arsimin fillor. Studentët eksplorojnë teoritë bashkëkohore të mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulës dhe metodat e kërkimit në arsim. Programi synon të përgatisë profesionistë të aftë për të udhëhequr dhe eksploruar në fushën e arsimit fillor.

Sfidat Aktualet:

- **Përputhja me Standardet Ndërkombëtare:** Sigurimi që programi të jetë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e arsimit.
- **Kërkimi Shkencor:** Nxitja e angazhimit të studentëve në kërkime shkencore dhe publikime akademike.
- **Bashkëpunimi Ndërinstitucional:** Zgjerimi i bashkëpunimeve me institucione të tjera arsimore për shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira.

Master në Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Përshkrimi i Programit: Ky program master fokusohet në avancimin e njohurive dhe aftësive në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Studentët studiojnë teoritë moderne të gjuhësisë dhe letërsisë, metodologjitë e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe zhvillojnë aftësi në analizën kritike dhe krijimtarinë letrare. Programi synon të përgatisë mësimdhënës të aftë për të promovuar gjuhën dhe kulturën shqipe në sistemin arsimor.

Sfidat Aktualet:

- **Përditësimi i përmbajtjes:** Integrimi i zhvillimeve të fundit në gjuhësi dhe letërsi në kurrikulë.

- **Metodologjitë e mësimdhënies:** Zbatimi i metodave interaktive dhe studenti në qendër gjatë mësimdhënies.
- **Promovimi i kërkimit:** Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në projekte kërkimore dhe konferenca shkencore.

Tabela e Planit të Veprimit

| Fusha e Veprimit | Aktiviteti | Afati | Përgjegjës | Indikatorët e Suksesit |
|--------------------------------------|--|---------|--------------------------------------|---|
| 1. Zhvillimi i Programeve Studimore | 1.1.Rishikimi dhe përditësimi i programeve baçelor dhe master | 12 muaj | Grupi Punues | Programe të rishikuara dhe të miratuara |
| | 1.2.Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie | 12 muaj | IT Stafi Akademik | Integrimi i mjeteve digjitale në klasa |
| | 1.3.Hartimi i programeve të reja studimore | 18 muaj | Dekani dhe Këshilli i Fakultetit | Miratimi i programeve të reja |
| | 1.4.Krijimi i programeve të reja master në fushat e specializuara | 18 muaj | Dekani dhe KF | Programe master të aprovuara |
| | 1.5.Përditësimi i përmbajtjes së literaturës mësimore | 9 muaj | Stafi Akademik | Literaturë e përditësuar |
| 2. Rritja e Cilësisë së Mësimdhënies | 2.1.Organizimi i trajnimeve për metodat e reja të mësimdhënies | 12 muaj | Dekani Koordinatori i Cilësisë ZZHAC | Numri i trajnimeve të mbajtura |
| | 2.2.Përdorimi i vlerësimeve të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies | 9 muaj | Stafi Akademik | Raporte të vlerësimit të mësimdhënies |
| | 2.3.Zhvillimi i Kursit online për | 12 muaj | IT dhe Stafi Akademik | Kurse online të disponueshme |

| | | | | |
|-----------------------------------|---|-------------------|--|---|
| | mësim në distancë | | | |
| | Inkurajimi i metodave interaktive në klasë | 6 muaj | Stafi akademik | Metoda interaktive të zbatuara |
| 3. Zhvillimi Profesional i Stafit | 3.1.Organizimi i konferencave shkencore | 12 muaj | Menaxhmenti i NJA | Numri i konferencave të organizuara |
| | 3.2.Inkurajimi për shkëmbime ndërkombëtare të stafit | 12 muaj 6 muaj | Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar | Numri i shkëmbimeve të realizuara |
| | 3.3.Trajnime për përdorimin e teknologjisë në kërkimin shkencor | 6 muaj | Zyra për Hulumtime dhe kërkime shkencore | Trajnime të realizuara për teknologji |
| | 3.4.Mbështetje për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare | 12 muaj | Dekani | Konferenca të ndjekura nga stafi |
| 4. Mbështetja për Studentët | 4.1.Zhvillimi i programeve të mentorimit | 12 muaj | Menaxhmenti i NJA | Raporte të mentorimit |
| | 4.2.Krijimi i grupeve mbështetëse për studentët | 9 muaj | Psikologu i Fakultetit | Grupet aktive mbështetëse |
| | 4.3.Ofrimi i këshillimeve të personalizuara për studentët | 12 muaj | Mentorët dhe Këshilltarët Akademikë | Numri i këshillimeve të ofruara |
| | 4.4.Krijimi i një platforme digjitale për këshillim | 9 muaj | Qendra për | Platforma funksionale për këshillim |
| 5. Përmirësimi i Infrastrukturës | 5.1.Modernizimi i sallave të ligjëratave | 12 muaj | Menaxhmenti i NJA | Salla të pajisura me teknologji të reja |
| | 5.2.Zhvillimi i bibliotekës me burime digjitale | 9 muaj | Bibliotekisti | Rritja e aksesit në burime digjitale |

| | | | | |
|------------------------|--|---------|---|--|
| | 5.3. Zgjerimi i laboratorëve për praktika të avancuara | 12 muaj | Zyra për Infrastrukturë | Laboratorë të zgjeruar dhe funksional |
| | 5.4. Furnizim i bibliotekës me libra të rinj | 12 muaj | Bibliotekisti | Tituj të rinj të teksteve |
| 6. Sigurimi i Cilësisë | 6.1. Implementimi i sistemit të vlerësimit të performancës | 12 muaj | Menaxhmenti i NJA Koordinatori I Cilësisë ZZHAC | Raporte të performancës së vlerësuar |
| | 6.2. Zbatimi i mekanizmave për feedback nga studentët | 6 muaj | Koordinatori i Cilësisë | Feedback i implementuar |
| | 6.3. Mbikëqyrje e sistemit të vlerësimit të stafit | 12 muaj | Koordinatori I cilësisë | Sistem i vlerësimit të zbatuar Raport permbledhës |